

Titulli i lëndës:

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë		
Titulli i lëndës:	Kontaktet e shqipes		
Niveli:	Bachelor		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	Bachelor, Semestri V		
Numri i orëve në javë:	2+0		
Kreditë ECTS:	6		
Koha / Vendi:	Departamenti i Gjuhës Shqipe, Fakulteti i Filologjisë Sipas orarit.		
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Shkumbin MUNISHI		
Të dhënat kontaktuese:	shkumbin.munishi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Lënda mësimore përqendrohet në studimin e dukurisë së kontakteve të gjuhëve dhe ndërndikimeve gjuhësore si karakteristikë e këtyre kontakteve. Në këtë lëndë paraqiten njohuri të përgjithshme për studimet në fushën e kontakteve të gjuhëve, të ndërndikimeve dhe të huazimeve gjuhësore. Po ashtu, ofrohen informata themelore teorike e konceptore lidhur me kontaktet e gjuhëve si dukuri sociolinguistike, me theks të veçantë në dukuritë që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me gjerësisht për dukurinë e kontakteve gjuhësore dhe me kontaktet e shqipes në veçant. Objektivi i kësaj lënde është që t’u ndihmojë studentëve të kuptojnë natyrën e kontakteve gjuhësore dhe dukuritë që i karakterizojnë këto kontakte. Në kuadër të kursit studentët do të marrin informacione të përgjithshme dukuritë që shfaqen si rezultat i kontakteve të gjuhëve dhe për natyrën e tyre. Në mënyrë specifike, ata do të njihen me format e huazimeve gjuhësore, me ndarjet dhe nëndarjet e tyre.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pasi ta ketë përfunduar me sukses modulin, studenti do të jetë në gjendje:		
	• të fitojë njohuri themelore mbi dukuritë e kontakteve gjuhësore,		
	• t’i kuptojë dukuritë e të huazuarit gjuhësor dhe llojet e huazimeve,		
	• ta kuptojë ndikimin e përgjithshëm të huazimeve në shoqëri dhe në gjuhë.		
	• Të njihen me kontaktet e shqipes me gjuhët e tjera në afërsi dhe në distancë..		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori / Punë në laborator / Ushtrime			
Punë praktike			

Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	12 minuta për student në javë	15	12 x 15 = 180, 3 orë
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	3	6
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	5		5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.			
Totali			75.00 orë 5 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, seminare dhe detyra.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 25% Vlerësimi i dytë: 30% Detyrat e shtëpisë : 10% Vijimi i rregullt: 5% Provimi final: 30% Total: 100%
Literatura primare:	Vesel Nuhiu, Ndikimet ndërgjuhësore, Rilindja, Prishtinë, 1990.
Literatura shtesë:	Sara G. Thomason, Language Contact, Georgetown University Press, Washington D.C., 2001

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	Hyrje në studimet e gjuhëve në kontakt. Kontaktet e shqipes me gjuhët e tjera.
Java 2:	Të huazuarit intim dhe të huazuarit kulturor.
Java 3:	Si ndikojnë gjuhët mbi njëra tjetrën.
Java 4:	Interferenca leksikore; huazimet leksikore në shqipe.
Java 5:	Analiza e të huazuarit gjuhësor.
Java 6:	Dygjuhësia individuale.
Java 7:	Raporti midis mikro-sociolinguistikës dhe makro-sociolinguistikës në studimin kush flet, cilën gjuhë, me kënd dhe kur.
Java 8:	Kontaktet gjuhësore.
Java 9:	Fonologjizmi dhe përtrirja e fonemave latente gjatë të huazuarit gjuhësor.
Java 10:	Hulumtimi mbi dygjuhësinë në botë.
Java 11:	Gjuhësia dhe kolonializmi.
Java 12:	Kontaktet gjuhësore të shqipes në Itali, Greqi dhe në diasporë.
Java 13:	Globalizimi dhe komunikimi gjuhësor në botë; shtrirja e anglishtes si gjuhë globale.
Java 14:	Shqipja dhe globalizimi
Java 15:	Sintezë e problemeve të diskutuara dhe ripërmbledhje e lëndës.

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët duhet t'i ndjekin me rregull ligjëratat. Në rast të mungesave të shumta të paarsyeshme studentëve nuk do t'u verifikohet pjesëmarrja e rregullt në ligjërata e ushtrime. Prania e studentëve në ligjërata dhe në ushtrime shënohet në fletët e evidencës dhe me regjistrim elektronik të pranisë.

Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave dhe provimeve.